



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga një parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 78-të, të mbajtur më 14.11.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-1775/1 datë 14.04.2020, NDËRPRITET
KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm ndaj lëndës.

Denoncimi t'i dërgohet Ministrisë së Punëve të Brendshme të RMV-së për veprime kompetente.

Lënda me numër 12-1775 të vitit 2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-1775/1 të datës 20.07.2020 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi panjohur. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për sjellje të pakujdesshme dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe kompetencave të zyrtarëve në ///, inspektorët ///, ///, /// dhe ///, të cilët në një procedurë për prokurim publik, nëpërmjet ndryshimeve në akte nënligjore, i kanë mundësuar subjektit privat /// të fitojë pozicion të privilegjuar, me qëllim për të marrë tender shtetëror dhe kjo në rrugë të favorizimit. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Pas inspektimit të përmbajtjes së raportit, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente nga /// dhe përgjigja e marrë nuk zbulon elemente për veprime të mëtejshme. Përkatesisht, personat ///, /// dhe /// nuk kanë më statusin e zyrtarit, si rezultat i të cilit KSHPK-ja nuk ka bazë për veprime të mëtejshme për këtë çështje. Gjithashtu, në mungesë të ///, për të hetuar pretendimet nga denoncimi, KSHPK-ja vlerëson se autoriteti kompetent i autorizuar me ligj për të ndërmarrë masa dhe veprime të mëtejshme për këtë temë është Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së, për këtë arsye ka vlerësuar denoncimin për t'ia përcjellë veprimin kompetent këtij autoriteti.

Bazuar në të theksuarën sa më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Arkivi i KSHPK -së
- Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: K.N.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

